



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18987 Prot.

Lezhë, më 28 /12/2023

VENDIM

Nr. 86, Datë 27. 12. 2023

**Për heqjen nga kontabiliteti i debitorëve që nuk justifikohen me dokumentacion  
financiar dhe ligjor**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, të ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

- 1.Miratimin e heqjes nga kontabiliteti të debitorëve që nuk justifikohen me dokumentacionin e nevojshëm financiar dhe ligjor për t'i mbledhur, debitorë përpara vitit 2010, të cilët janë të kontabilizuar në llogarinë kontabël 468 me vlerë 29,905,761 lekë, sipas listës bashkëlidhur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI

Në mungesë dhe me autorizim  
ZV/KRYETARI  
AGOSTIN MARKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Prot 18987/1  
Dt. 8.1.24.  
K.B

Nr. 1044 / Prot.  
16

Lezhë, më 03 .01 .2024

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar", nenit 112 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.86, datë 27.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për heqjen nga kontabiliteti i debitorëve që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

  
  
